

# Treguesit demografikë

## Tremujori IV – 2021


**Tiranë, më 11 shkurt 2022:** Numri i lindjeve për tremujorin e katërt 2021 është 6.939, duke shënuar një rënie me 1,0 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2020. Gjatë vitit 2021 lindën 27.284 foshnja, duke shënuar një rënie me 2,8 %, krahasuar me një vit më parë.

Numri i vdekjeve për tremujorin e katërt 2021 është 7.837, duke shënuar një rënie prej 16,6 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2020. Gjatë vitit 2021 humbën jetën 30.580 persona, duke shënuar një rritje me 10,8 %, krahasuar me një vit më parë.

Shtesa natyrore e popullsisë në tremujorin e katërt 2021 tregon se janë 898 vdekje më shumë se sa lindje. Në vitin 2021 shtesa natyrore ishte 3.296 vdekje më shumë se sa lindje.

Shqipëria është karakterizuar nga shtesë natyrore pozitive ndër vite. Shtesa natyrore negative për vitin 2021 është ndikuar edhe nga situata e pandemisë Covid-19.

Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë




Në tremujorin e katërt 2021, pesë qarqe të vendit kanë shënuar shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në shtatë qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë ishte negative.

Në tremujorin e katërt 2021, qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana, me 460 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Korça, me 349 vdekje më shumë se sa lindje.

Gjatë vitit 2021, katër qarqe të vendit shënuan shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në tetë qarqet e tjera shtesa natyrore e popullsisë ishte negative.

Gjatë vitit 2021, qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana, me 1.642 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Vlora, me 1.222 vdekje më shumë se sa lindje.

**Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T4 – 2021**



### Lindjet

Në tremujorin e katërt 2021, katër qarqe të vendit shënojnë rritje të numrit të lindjeve, në krahasim me tremujorin e katërt 2020, ndërsa tetë qarqet e tjera shënojnë ulje në krahasim me të njëjtën periudhë.

Në tremujorin e katërt 2021, qarku me numrin më të lartë të lindjeve është Tirana me 2.514 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët është Gjirokastra me 113 lindje.

Rritjen më të lartë në përqindje të lindjeve gjatë tremujorit të katërt 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 e zë qarku i Beratit me 13,7 %, ndërsa rënien më të madhe e ka qarku i Dibrës me 15,7 %.

Gjatë vitit 2021, pesë qarqe të vendit shënuan rritje të numrit të lindjeve, në krahasim me vitin 2020, ndërsa shtatë qarqet e tjera pësuan rënie.

Gjatë vitit 2021, qarku me numrin më të lartë të lindjeve është Tirana me 9.473 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët është Gjirokastra me 451 lindje.

Rritjen më të lartë në përqindje të lindjeve gjatë vitit 2021, krahasuar me vitin 2020 e zë qarku i Kukësit me 3,9 %, ndërsa rënie më të madhe e ka qarku i Elbasanit me 11,3 %.

**Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve**

Nr.	Qarku	2020	2021	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2020	T4 - 2021	Ndryshimi tremujor në %
	<b>Shqipëria</b>	<b>28.075</b>	<b>27.284</b>	<b>-2,8</b>	<b>7.011</b>	<b>6.939</b>	<b>-1,0</b>
1	Berat	1.048	1.051	0,3	249	283	13,7
2	Dibër	1.541	1.470	-4,6	389	328	-15,7
3	Durrës	3.005	2.980	-0,8	781	750	-4,0
4	Elbasan	2.709	2.402	-11,3	709	622	-12,3
5	Fier	2.582	2.385	-7,6	689	586	-14,9
6	Gjirokastrë	504	451	-10,5	125	113	-9,6
7	Korçë	1.696	1.647	-2,9	369	411	11,4
8	Kukës	870	904	3,9	267	226	-15,4
9	Lezhë	1.300	1.303	0,2	299	328	9,7
10	Shkodër	1.866	1.900	1,8	483	464	-3,9
11	Tiranë	9.387	9.473	0,9	2.307	2.514	9,0
12	Vlorë	1.318	1.233	-6,4	323	287	-11,1
	*Të panjohur	249	85		21	27	

\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja mungon.<sup>1</sup>

### Vdekjet

Në tremujorin e katërt 2021, njëmbëdhjetë qarqe të vendit shënojnë ulje të numrit të vdekjeve, në krahasim me tremujorin e katërt 2020, ndërsa vetëm një qark shënon rritje në krahasim me të njëjtën periudhë.

Në tremujorin e katërt 2021, qarku me numrin më të ulët të vdekjeve është Kukësi me 166 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të lartë është Tirana me 2.054 vdekje.

Uljen më të madhe në përqindje të vdekjeve gjatë tremujorit të katërt 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 e zë qarku i Lezhës me rënie prej 24,6 %, ndërsa rritjen më të madhe e ka qarku i Vlorës me 3,0 %.

<sup>1</sup> Shiko metodologjinë në linkun në vijim: <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

Gjatë vitit 2021, vetëm një qark i vendit shënoi ulje të numrit të vdekjeve, në krahasim me vitin 2020, ndërsa njëmbëdhjetë qarqe të tjerë shënuan rritje në krahasim me të njëjtën periudhë.

Gjatë vitit 2021, qarku me numrin më të ulët të vdekjeve është Kukësi me 612 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të lartë është Tirana me 7.831 vdekje.

Uljen më të madhe në përqindje të vdekjeve gjatë vitit 2021, krahasuar me vitin 2020 e zë qarku i Kukësit me rënie prej 2,4 %, ndërsa rritjen më të madhe e ka qarku i Vlorës me 33,2 %.

**Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve**

Nr.	Qarku	2020	2021	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2020	T4 - 2021	Ndryshimi tremujor në %
	<b>Shqipëria</b>	<b>27.605</b>	<b>30.580</b>	<b>10,8</b>	<b>9.397</b>	<b>7.837</b>	<b>-16,6</b>
1	Berat	1.434	1.681	17,2	500	453	-9,4
2	Dibër	1.038	1.085	4,5	307	263	-14,3
3	Durrës	2.554	2.791	9,3	918	699	-23,9
4	Elbasan	2.712	2.875	6,0	923	746	-19,2
5	Fier	3.112	3.601	15,7	1.147	904	-21,2
6	Gjirokastrë	914	1.043	14,1	297	279	-6,1
7	Korçë	2.579	2.726	5,7	837	760	-9,2
8	Kukës	627	612	-2,4	199	166	-16,6
9	Lezhë	1.306	1.352	3,5	423	319	-24,6
10	Shkodër	2.342	2.490	6,3	781	610	-21,9
11	Tiranë	7.129	7.831	9,8	2.504	2.054	-18,0
12	Vlorë	1.843	2.455	33,2	558	575	3,0
	<i>*Të panjohur</i>	15	38		3	9	

*\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar vdekja mungon.*

## Anekse

**Tab. 3 Lindjet - tremujorët me të dhëna finale**

Nr.	Qarku	IV - 20	I - 21	II - 21	III - 21	IV - 21
	<b>Shqipëria</b>	<b>7.011</b>	<b>6.321</b>	<b>6.333</b>	<b>7.691</b>	<b>6.939</b>
1	Berat	249	270	222	276	283
2	Dibër	389	359	380	403	328
3	Durrës	781	674	665	891	750
4	Elbasan	709	576	529	675	622
5	Fier	689	556	556	687	586
6	Gjirokastrë	125	119	96	123	113
7	Korçë	369	374	398	464	411
8	Kukës	267	186	212	280	226
9	Lezhë	299	303	302	370	328
10	Shkodër	483	440	492	504	464
11	Tiranë	2.307	2.153	2.149	2.657	2.514
12	Vlorë	323	291	307	348	287
	<i>*Të panjohur</i>	21	20	25	13	27

*\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon.*

**Tab. 4 Vdekjet - tremujorët me të dhëna finale**

Nr.	Qarku	IV - 20	I - 21	II - 21	III - 21	IV - 21
	<b>Shqipëria</b>	<b>9.397</b>	<b>10.222</b>	<b>6.115</b>	<b>6.406</b>	<b>7.837</b>
1	Berat	500	552	343	333	453
2	Dibër	307	387	220	215	263
3	Durrës	918	969	531	592	699
4	Elbasan	923	970	598	561	746
5	Fier	1.147	1.243	706	748	904
6	Gjirokastrë	297	313	233	218	279
7	Korçë	837	766	605	595	760
8	Kukës	199	183	140	123	166
9	Lezhë	423	453	243	337	319
10	Shkodër	781	689	539	652	610
11	Tiranë	2.504	2.810	1.463	1.504	2.054
12	Vlorë	558	878	485	517	575
	<i>*Të panjohur</i>	3	9	9	11	9

*\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.*

**Tab. 5 Shtesa natyrore e popullsisë - tremujorët me të dhëna finale**

Nr.	Qarku	IV - 20	I - 21	II - 21	III - 21	IV - 21
	<b>Shqipëria</b>	<b>-2.386</b>	<b>-3.901</b>	<b>218</b>	<b>1.285</b>	<b>-898</b>
1	Berat	-251	-282	-121	-57	-170
2	Dibër	82	-28	160	188	65
3	Durrës	-137	-295	134	299	51
4	Elbasan	-214	-394	-69	114	-124
5	Fier	-458	-687	-150	-61	-318
6	Gjirokastër	-172	-194	-137	-95	-166
7	Korçë	-468	-392	-207	-131	-349
8	Kukës	68	3	72	157	60
9	Lezhë	-124	-150	59	33	9
10	Shkodër	-298	-249	-47	-148	-146
11	Tiranë	-197	-657	686	1.153	460
12	Vlorë	-235	-587	-178	-169	-288
	*Të panjohur	18	11	16	2	18

\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton rastet për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja dhe/ose vdekja mungon.

# Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021.

## Lindjet

### *Të dhënat e lindjeve:*

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të lindjeve*

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

## Vdekjet

### *Të dhënat e vdekjeve*

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të vdekjeve*

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

**Përkufizime:**

*Shtesa natyrore e popullsisë:* Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

*Lindje e gjallë:* Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

*Vdekje:* Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).